

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

RAPORTI TRE MUJOR JANAR-MARS 2023

1. E rëndësishme për DKA-në dhe të gjitha institucionet edukativo arsimore është se tani ne kemi hartuar Planin Zhvillimor të Arsimit në nivel Komunal, i cili ka munguar tani e disa vite, tani ne veç e dimë rrugën se ka do të shkojmë për katër vitet në vijim. I cili pritet që të aprovohet në Kuvendin Komunal.
2. Përveç planit zhvillimor në kuadër të planit të veprimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit për vitin 2023, kemi identifikuar nevojat dhe e kemi parë shumë të domosdoshme të krijojmë infrastrukturën nënligjore në sektorin e arsimit duke krijuar rregulla të sjelljes për nxënësit dhe mësimmshënësist si dhe duke i harmonizuar ato me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Gjatë kësaj periudhe kohore jemi fokusuar dhe kemi hartuar katër projekt akte si vijon:
 - Projekt Rregullore për Marrëdhënien Juridike të Punës në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit parauniversitar në Komunën e Gjilanit.
 - Plotësim Ndryshimi i Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Gjilanit, 01 Nr. 016-53313/21 të datës 27.05.2021.
 - Projekt Rregullore për të drejtat, detyrimet, disiplina dhe përgjegjësitë e nxënësve në shkollat fillore të mesme të ulëta në Komunën e Gjilanit.
 - Projekt Rregullore për Përgjegjësinë Disiplinore të Punonjësve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese në Komunën e Gjilanit.
4. Kemi bërë përgatitje teknike për realizmin e testeve kombëtare dhe ndërkombëtare (testi i maturës dhe ndërkombëtare testi TIMMS DHE ICIRLS NDËRSA JEMI DUKE I REALIZUAR GARAT KOMUNALE TË MATEMATIKËS.
5. Kemi aplikuar në MASHT për digjitalizimin e shkollave gjë e cila pritet brenda këtij viti që të furnizohemi me pajisje digjitale, gjithashtu për nevoja infrastrukturore të shkollave profesionale kemi aplikuar për projekte në MASHT.
6. Kemi struktura dhe organizuar mënyrën e shërbimit profesional në shkolla dhe aktualisht jemi në fazën të shpalljes së konkursit për shërbyes profesional pedagog dhe psikolog, të cilët pritet të trajnohen për punën e tyre që do ta bëjnë në shkolla,
7. Kemi iniciuar edhe tre laborator të shkencave natyrore.
8. Sa i përket infrastrukturës kemi Inauguruar çerdhen në Zhegër, Shkollën fillore Rexhep Elmazi, Shkollën profesionale Mehmet Isai, si dhe laboratorët e CNC-së në dy shkolla, si dhe së fundi kabinetin e Autocadit në shkollën profesionale teknike Mehmet Isai.
9. Tanimë për nxënësit nuk do të ketë ngarkesa e çanta të rënda në shpinë sepse ne kemi bërë planifikimin e dollapëve individual që pritet me fillim të muajit maj të pajiset çdo nxënës me dollap individual nga klasa 1-5
10. Përveç këtyre për të rritur sigurinë për nxënësit e shkollave fillore kemi shpërndarë rripa të sigurisë për të gjithë nxënësit e klasës së I.

11. Sa i përket donacioneve gjatë këtij tre mujori ne kemi pranuar donacione për dy shkolla nga Alled-2 për shkollën e mesme të Agrobiznesit dhe për shkollën e mesme profesionale Mehmet Isai përfshirë 6 tabela të mençura, 30 laptop, 2 kompjuter për tabela të mençura
12. Kemi rinovuar dhe gëlqerosur hapësira se ku janë të nevojshme si: kulmi tek çerdhja integj, gëlqerosje te shkolla fillore Nazmi Hoxha,
13. Dhe një çerdhe me tepër, kemi vënë gurë themelin e çerdhes tek Qarki 1, e cila do të ketë kapacitetin që të përfshijë fëmijët e moshës nga 9 muaj deri në 5 vjeç.
14. Nga muaji prill kanë filluar punimet në shkollën fillore Abaz Ajeti mbështetur nga fondi i eficiencës.
15. Sa ju përket marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe projekteve të fituara: kemi fituar projektin “Take” mbështeture nga Karitasi Zviceran projekt ky i cili do të ofrojë pajisje me inventarë dhe me materiale didaktike për edukimin para fillorë, të cilat kontribuojnë për rritjen e cilësisë në edukimin parashkollorë, trajnimin e edukatoreve si dhe aktivitete të tjera të cilat rrisin cilësinë në edukimin e hershëm.
16. Marrëveshje bashkëpunimi me Olimpiadën speciale të Kosovës, të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta do të angazhohen në aktivitete sportive si: atletikë, basketboll, not, boëlling,
17. Marrëveshje bashkëpunimi me qendrën profesionale që ka për qëllim promovimin e gjithë përfshirjes dhe ndryshimit social.
18. Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-n TOKA,
19. Për herë te parë është hapur qendra e karrierës në nivel komunal, kjo qendër do të shpërbejë për të orientuar të rinjtë në karrierë dhe me tregun e punës,
20. Ne si drejtori komunale nga muaji shkurt e deri më tani, kemi marrë iniciativë për të ofruar këshillim në karrierë për nxënësit tanë dhe orientim profesional, duke ofruar mundësin që të gjithë nxënësit e shkollave fillore respektivisht klasat e 9-ta të ndjekin orë praktike në shkolla profesionale përveç kësaj ne kemi organizuar promovim të profileve profesionale ku do të kenë mundësi të njoftohen të gjithë prindërit e nxënësve të klasave të 9-ta me këto profile dhe më gjerë.
21. Së fundmi janë organizuar dhe mbajtur garat e fizikës ku nuk mungoi performanca e nxënësve tanë duke u zgjedhur fitues në tri vendet e para.